VENDIM
Nr. 312, datë 15.5.2019

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË PASURIVE "OBJEKTE DHE TRUALL TË AGJENCISË SË REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT LABINOT, ELBASAN", DHËNË ME KONTRATA ME ÇMIMIN 1 EURO/KONTRATA SHOQËRISË "ROZAFA", SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2, të aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim të shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros të këtyre ndërmarrjeve", miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008", të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 32, të kreut III, të vendimit nr. 926, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për fillimin e procedurave të privatizimit të pasurive shtetërore të dhëna me qira me kontratën me çmimin 1 euro/kontrata, njësi në administrim të Agjencisë së Rezervave Materiale të Shtetit, Labinot, Elbasan, miratuar me vendimin nr.873, datë 30.10.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë "Rozafa" sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë "Objekte të Agjencisë së Rezervave të Shtetit, Labinot, Elbasan", të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit".
2. Dhënien e miratimit për fillimin e procedurave të privatizimit të pasurive shtetërore të dhëna me qira me kontratën me çmimin 1 euro/kontrata, njësi në administrim të Agjencisë së Rezervave Materiale të Shtetit, Labinot, Elbasan, miratuar me vendimin nr.266, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë "Rozafa", sh.p.k, si qiramarrës, për pasurinë "Objekte dhe truall, të Agjencisë së Rezervave Materiale të Shtetit Labinot, Elbasan (pjesa e mbetur)", të Ministrisë së Punëve të Brendshme".
3. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 30.10.2015, dhe nr. 266, datë 29.3.2017, shfuqizohen në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitjes së pasurive shtetërore të përmendura në këtë vendim.
4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe